



Pranuar / Dosturuar / Received / Delivered	12.04	2021	viti / year
Organ / Njësia / Organ / Jedinstvo / Org. / Unit	No. Prot. / Prot. No.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPM/SHIK	1731/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.102/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Hysni Mustafa - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.102/2021 të datës 25.02.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga “Zenel Salihu”, nr.4, Ndërtesa e ASK-së, në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve të punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 12.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. ANULOHET Vlerësimi i Rezultateve në Punë për vitin 2020, i datës 27.01.2021 për ankuesen
- II. OBLIGOHET Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjnë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 për nëpunësen civile
- III. OBLIGOHET Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës sipas akt emërimit Nr.04-112-201 të datës 30.03.2012 në pozitën “Menaxhere e Personelit”, në Departamentin e Administratës, me datë 27.01.2021 ka pranuar formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 nga Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e saj, me të cilin është vlerësuar me notën e përgjithshme 2.48.

Ankuesja, në Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil ka dhënë koment, duke shprehur pakënaqësinë e saj lidhur me vlerësimin. Ankuesja, pakënaqësinë lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë e ka shprehur edhe përmes emailit zyrtar të datës 01.02.2021, drejtuar udhëheqëses së drejtpërdrejt.

Ankuesja, kundër vlerësimin të rezultateve të punës për vitin 2020, me datën 25.02.2021 ka parashtruar ankesën me nr. prot: 828/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që vlerësimi i rezultateve të punës është bërë pa mbajtur asnjë takim paraprak nga ana e mbikëqyrësit të saj, vlerësimi ndaj saj nga ana e mbikëqyrëses është jo real, i pa bazuar, tendencioz dhe diskriminues, si dhe pretendimi se vlerësimi i rezultateve në punë është bërë në kundërshtim me Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimin të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave ligjore në fuqi me datën 01.03.2021 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Me datën 09.03.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokoll 828/2021 të datës 25.02.2021; Akt emërimin e ankueses Nr.04-112-201, të datës 30.03.2012; Emalin zyrtar të datës 01.02.2021; Emalin zyrtar të datës 03.02.2021; Emalin zyrtar të datës 28.01.2021; Emalin zyrtar të datës 27.01.2021; Emalin zyrtar të datës 20.01.2021; Emalin zyrtar të datës 18.01.2021; Emalin zyrtar të datës 17.01.2021; Formularin për vlerësimin e detyrave i datës 06.01.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional, për vitin 2020, i nënshkruar me datës 27.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; kërkesa për përgjigje e datës 01.03.2021; përgjigja në kërkesë e datës 09.03.2021; Përshkrimi i detyrave të punës i ankueses i datës 21.10.2013.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankueses të kthehet në rivlerësim, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me vlerësimin e ankueses për vitin 2020, ka konstatuar se Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses konkretisht Drejtoresha e Departamentit të Administratës në ASK, me rastin e vlerësimin të ankueses me notën e përgjithshme 2.48, tek pjesa e komenteve për objektivat, vlerësuesja ka theksuar se: *“Ne objektivin e punës 4 ka treguar përbormani në realizimin e detyrave”*, e që në Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional, për vitin 2020 për ankuesen, Kolegji ka



konstatuar se objektivi 4 - Procedurat e vlerësimit të performancës dhe përgatitja e raporteve, ankuesja është vlerësuar me notën 2, e kjo e bënë raportin e vlerësimit kundërthënës dhe të paqartë me vetveten. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me vlerësimin e ankueses për vitin 2020, përveç komentit të lartcekur vlerësuesja nuk ka shprehur mendimin se pse është vlerësuar ankuesja me këtë notë, gjegjësisht nuk ka shpjeguar dhe nuk ka dhënë mendimin lidhur me përmbushjen apo jo të njëres prej objektivave dhe detyrave të punës, e krejt kjo është bërë në kundërshtim me Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe të Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga provat e lëndës, respektivisht Formularët për vlerësimin e rezultateve në punë për vitet 2017, 2018, 2019 për ankuesen, konstaton se vlerësuesja është e njëjta dhe se në të gjithë formularët e lartcekur për vlerësimin e rezultateve në punë, komentet e vlerësueses për realizimin e objektivave kanë qenë: *"Ne objektivat e punës ka treguar performanc të lartë në realizimin e detyrave të saja"*, rrjedhimisht nga kjo Kolegji konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesen është në mospërputhje të plotë edhe me 3 vitet paraprake, e ku vlerësuesja dhe e vlerësuara kanë qenë të njëjta.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020, pa pasur asnjë takim paraprak nga mbikëqyrësja e saj e drejtpërdrejtë, ka konstatuar se është i qëndrueshëm sepse nuk ka asnjë dëshmi që udhëheqësja e drejtpërdrejt e ankueses në fund të periudhës së vlerësimit ka ftuar ankuesen për të diskutuar për realizimin e objektivave dhe rezultateve të arritura, ashtu siç parashihet me nenin 43 paragrafin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *"Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të"*, si dhe në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, i cili përcakton se: *"Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesional të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; vlerësimin (notimi) e objektivave"*, po ashtu në provat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që mbikëqyrësja është takuar me ankuesen gjatë periudhës vlerësuese për të rishikuar progresin e bërë siç parashihet me nenin 43 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *"Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime më nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuar për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim"*, si dhe nenit 7 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime më nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësimet e nevojshme"*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se në bazë të provave të lëndës është vërtetuar se ankuesja nuk është vlerësuar drejtë lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020, respektivisht Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses me rastin e vlerësimit të ankueses ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe



Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, si udhëheqësin më të lartë administrativ që të ndërmarrë te gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi, ndërsa Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses në pajtim me të gjeturat e këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 për ankuesen Shqipe Makolli, si dhe të gjitha procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t'i zhvilloj në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.102/2021

Hysni Mustafa

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

